

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me trupin gjykues në përbërje Agim Maliqi kryetar i trupit gjykues dhe anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët Hysnije Gashi dhe Ilir Bytyqi si dhe me procesmbajtësen Albana Ajvazi, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.B., për shkak të veprës penale në falsifikimi i parasë nga neni 244 par. 1 të KPK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë, PP. nr. 607-5/2010 të datës 25.11.2010, pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor, me datat 23.09.2016, 06.10.16 dhe 17.10.2016, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit, Rasim Maloku, të akuzuarit S.B. me mbrojtësin e tij av. H.G., me datë 17 tetor 2016, mori dhe komunikoi kurse me 21 tetor 2016, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **S.B.**, nga i ati Sh. dhe e ëma Z. e vajzërisë B., data e lindjes..... në ....., me vendbanim në ..... rr.”.....” nr. ..., shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me dt. 03.10.2010 në Prishtinë ka vënë në qarkullim para të falsifikuara në kartëmonedha dhe atë 1x 50 € me nr. serik X26068722464, 29 X 10 € me numër të njëjtë serik N54209910414 dhe 27 x 20€ me numër të njëjtë serik U68396701172 në shumë të përgjithshme prej 880€, në atë mënyrë që paratë e falsifikuara i ka siguruar nga persona tani të panjohur dhe të njëjtat ia ka dhënë të gjykuarit M.R. në mënyrë që prej tij të merr shumën e parave origjinale prej 150€, e të cilat para të falsifikuara të gjykuarit M.R. dhe N.N. pastaj i kanë vënë në qarkullim në komunën e Shtërpcës siç përshkruhet në aktgjykimin 433/2010 të kësaj Gjykate.

**Me këtë ka kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 1 të KPRK-së.**

**Andaj në bazë të dispozitave të nenit 302 par. 1 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75 dhe 83 të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPP-ës, i**

## **SHQIPTON**

**ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 7 /SHTATË/MUAJ, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 03.11.2010 deri më 02.12.2010 dhe prej datës 31.08.2016 deri me 17.10.2016.**

**Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50/pesëdhjetë/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.**

## **A r s y e t i m i**

### **1. Historiku i procedurës**

Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, ka paraqitur akuzën PP. nr. 607-5/2010 të datës 25.11.2010, ndaj të akuzuarve M.R., N.N. dhe S.B.<sup>1</sup>, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje falsifikimi i parasë nga neni 244 par. 1 dhe 2 të KPK-ës.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktvendimin KA 400/2010 të dt. 21.12.2010 ka konfirmuar aktakuzën ndaj të akuzuarve M.R., N.N. dhe S.B., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje falsifikimi i parasë nga neni 244 par. 1 dhe 2 të KPK-ës.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor në datat 23.09.2016, 06.10.16 dhe 17.10.2016, në të cilin shqyrtim përfaqësuesi i akuzës-Prokurori i Shtetit Rasim Maloku, në fazën e ndryshimit të akuzës ndryshoi akuzën ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, kurse deri në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë akuzës së ndryshuar dhe kualifikimit juridik të veprës penale, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të i shqiptohet dënim i paraparë sipas ligjit, për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 244 par. 1 të KPK-ës.

---

<sup>1</sup> Gjykata me aktgjykimin P.nr.433/10 të dt.14.03.2014, ka shpallur fajtor të akuzuarit M.R. dhe N.N., kurse ka veçuar procedurën ndaj të akuzuarit S.B. me që i njejtë gjendej jashtë shtetit në Gjermani.

## **2. Mbrojtja e të akuzuarit**

I akuzuari S.B., në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale në fjalë, kurse me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së tij ka kontestuar faktet se me datë, kohë dhe vend siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi ka furnizuar me para dëshmitarin M.R., duke mos kontestuar faktin se të njëjtin e ka njohur në bazë të N. i cili ka qenë shofer në një ministri nga fakti se ka qenë i interesuar që të nxjerrë letërnjoftimin në Serbi dhe pasi që nuk e ka ditur gjuhën serbe së bashku edhe me disa persona të tjerë, kanë shkuar në qytetin e Nishit për të nxjerrë letërnjoftimin. Më tutje ka shtuar faktin se nuk ka poseduar ndonjë aparat për rregullimin e parave të falsifikuara, po ashtu asnjëherë nuk i ka dhënë të holla të falsifikuara M.R., për më tepër nuk e ka mohuar faktin se në telefonin e tij nga M.R. i kishte shkuar një sms të cilin ai ia kishte dërguar, por atë sms menjëherë nuk e kishte parë, por e kishte parë pas disa ditësh për më tepër nuk kishte vepruar sipas tij dhe nuk e kishte kuptuar se çka ishte përmbajtja e tij.

Po ashtu më tuje gjatë mbrojtjes së tij ka pohuar se posedonte numrin e telefonit ..... dhe ky telefon ka qenë i tij, ashtu që disa herë ka kontaktuar edhe me M.R.in por se bisedat kanë qenë lidhje me nxjerrjen e letërnjoftimit dhe jo për çështje tjera.

## **3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Pasi që i akuzuari, nuk ka pranuar fajësinë sipas pretendimeve të akuzës, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPP-ës, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- nga dëshmia e dëshmitarëve S.S., D.S., N.N. dhe M.R.<sup>2</sup>;

---

<sup>2</sup> Pasi që ndaj të dënuarve N.N. dhe M.R. procedura kishte përfunduar me aktgjykim të forms së prerë sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.433/10 të dt.14.03.2014, cili aktgjykim është bërë i

- nga leximi i raportit të ekspertizës i dt. 15.10.2010;
- nga shikimi në raportin e thirrjeve telefonike dhe SMS për numrin e telefonit .....
- nga shikimi në fotografitë e parave të falsifikuara.

#### **4.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Fillimisht Gjykata vlerëson si të vërtetuar dhe të pakontestueshme aspektin objektiv përkatësisht faktet si në vijim:

- se bankënotat dhe atë 1x 50 € me nr. serik X26068722464, 29 X 10 € me numër të njëjtë serik N54209910414 dhe 27 x 20€ me numër të njëjtë serik U68396701172 janë të falsifikuara;

- se në kafiterin “.....” në Shtërpcë janë vënë në qarkullim para të falsifikuara dhe atë M.R. bankënotën e falsifikuar prej 20€, kurse N.N. bankënotën e falsifikuar prej 10€;

- në kafiterinë “..... & .....” M.R. ka vënë në qarkullim bankënotën e falsifikuar prej 50€, kurse N.N. bankënotën e falsifikuar prej 20€, të cilat i kanë shfrytëzuar për pagesën e pijeve;

Andaj në këtë çështje penale ka qenë kontestuese vërtetimi i fakteve për implikimin e të akuzuarit S.B. përkatësisht furnizimi i tij me para të falsifikuara tani dëshmitarëve M.R. dhe N.N..

Përmbajtja e dëshmive të dëshmitarëve D.S., S.S. dhe N.N. nuk kanë paraqitur asnjë relevancë në këtë çështje penale, dëshmitë e tyre mund të përmbliidhen në vërtetimin e fakteve periferike ndaj të pandehurit ngase të njëjtit përveç faktit se e njihnin të pandehurin dëshmitarët (D.S. dhe S.S.) kishin një raport kontraktual me të pandehurin për shitblerjen e pajisjeve për riparimin e gomave, kurse dëshmitari N.N. as që e njihnte të pandehurin, andaj edhe nuk është e nevojshme më tepër të elaborohen dëshmitë e këtyre dëshmitarëve.

Përmes dëshmisë së dëshmitarit M.R. është vërtetuar fakti se dëshmitari paraprakisht kishte qenë i dënuar për veprën penale falsifikimi i parasë, të cilën vepër e kishte kryer në Shtërpcë dhe atë së bashku me N.N. dhe S.S. dhe këto para të falsifikuara i ka marrë nga S.B., të cilin e ka njohur përmes një shoku të tij, përndryshe të njëjtin e ka ndihmuar që të nxjerrë letërnjoftimin duke e dërguar në qytetin e Nishit dhe nga ajo kohë kam pasur një lloj

---

formës së prerë me aktgjykimin PAKR.nr.244/2014 i dt.16.06.2014, andaj nuk ishte pengesë që të njëjtit të dësgjohen në cilësinë e dëshmitarëve.

shoqërie me të, gjithashtu me të ka pasur edhe kontakte telefonike dhe përmes SMS, ashtu që dëshmitari pas prezantimit nga ana e Prokurorit të Shtetit pohon se nga numri i telefonit ....., ka dërguar sms me përmbajtjen “*pare pravi let nize*” të cilin ia ka dërguar S.B.t, me qëllim që i njëjti ti përgatis paratë e falsifikuara, ashtu që S.B. mi ka dhënë shumën diku prej 870€ dhe atë në bankënota prej nga 5, 10, 20, 50€ e të cilat para S.B. ia ka dhënë në zarf – kuvertë, kurse S.B. nuk i ka dhënë asgjë, por ka qenë dashur që të ia jep 150€, por këto para nuk i ka pasur ashtu që ka pasur që t’ia jap S.B. kur ti lëshojnë këto paratë e falsifikuara në qarkullim.

Bazuar në faktin se skeleti i kësaj aktakuze është i ndërtuar mbi dëshminë e dëshmitarit M.R., andaj edhe këtë dëshmi Gjykata do ta vlerësoj në mënyrë të kujdesshme dhe të posaçme dhe atë për faktet si në vijim:

- së pari nga fakti se dëshmia e tij ishte mjaft e rëndësishme meqë ishte dëshmitar okular i ngjarjes;
- se personalisht kishte bërë pranimin e parave të falsifikuara nga i pandehuri;
- dhe përfundimisht nga fakti se dëshmitari paraprakisht ishte i pandehur dhe se çështja ndaj tij ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë.

Andaj, dëshminë e këtij dëshmitari, Gjykata i vlerësoi si objektive dhe të saktë nuk pati as edhe një arsye qoftë objektive apo subjektive që do ta dëmtonte besueshmërinë e tij e besueshmërinë e kësaj dëshmie e rrit sidomos fakti se kjo dëshmi është në përputhshmëri të plotë edhe me SMS e dt. 02.10.2010, që dëshmitari përmes telefonit të tij ..... i kërkon të pandehurit para “*pravi pare let nize*” dhe atë vetëm një ditë para se të njëjtat ti merrte dhe ti dërgonte në Shtërpçë.

Se vërtetë kemi të bëjmë me një dëshmi reale padyshim se kjo vërtetohet edhe përmes faktit se pohimet e dëshmitarit ishin tërësisht të ngjashme edhe me mbrojtjen e tij (të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor P.nr.433/10) dhe gjithashtu këtë dëshmi duhet vlerësuar në kontest të kohës së kaluar se tani dëshmitari nuk kishte ndonjë interes që ta inkriminonte të pandehurin pasi që tani çështja ndaj tij tashmë ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë.

Kredibiliteti i dëshmisë së tij u përforcua dhe absolutisht nuk u vu në dyshim përkundër faktit se mbrojtësi i të pandehurit duke u thirrë në mbrojtjen e të pandehurit dhenë gjatë procedurës hetimore duke e ballafaquar me këtë mbrojtje nuk arriti absolut të lëkund dëshminë e këtij dëshmitari i cili qartazi pohoi faktin se deklarimi i sotëm i tij ishte i vërtetë

dhe se gjatë hetimeve ka dashur që fajin ta merr për vete për më tepër dëshmia e tij e tanishme është e logjikshme, objektive meqë kjo dëshmi në mënyrë të detajuar përshkroi tërësinë e ngjarjes e për më tepër ishte e ngjashme edhe me mbrojtjen e të pandehurit (M.R.) e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor (P.nr.433/10).

Kurse përmes provave materiale (leximi i raportit të ekspertizës i dt. 15.10.2010, shikimi në raportin e thirrjeve telefonike dhe SMS për numrin e telefonit ..... dhe shikimi në fotografitë e parave të falsifikuara), Gjykata vlerëson se janë prova të besueshme dhe vërtetohet se paratë e vëna në qarkullim janë të falsifikuara, kurse raportet e thirrjeve dhe sms të nxjerra në mënyrë të ligjshme nga ana e Prokurorit të Shtetit.

##### **5. Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit dhe pretendimi i mbrojtësit të tij**

Mbrojtja e të akuzuarit S.B. në të gjitha fazat e procedurës penale është përqendruar në kundërshtimin e fakteve se kishte kryer këtë vepër penale e përshkruar në akuzë por pa paraqitur hollësi dhe detaje për këtë çështje.

Por Gjykata tezës së të akuzuarit nuk i besoi për faktet vendimtare të kësaj çështje përkatësisht parave të falsifikuara nga fakti se së pari nuk pati mbështetje në asnjë provë tjetër për më tepër u demantua edhe nga vet provat e prezantuara e posaçërisht dëshmia e dëshmitarit M.R. (e elaboruar hollësisht në pjesën e epërme të këtij aktgjykimi), ashtu që mbrojtja e tij ishte e pabesueshme, kurse pjesa tjetër e mbrojtjes që i referohej raporteve me dëshmitarin ishin të dhëna irelevante dhe të parëndësishme siç ishin (shkuarja e tij me dëshmitarin për në Serbi).

Gjykata duke vlerësuar pretendimet e avokatit H.G., i cili vlerëson se nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale 244 par.1 të KPK-së dhe duke i propozuar Gjykatës që të pandehurin ta liron nga akuza në mungesë të provave.

Më tutje mbrojtësi i të pandehurit konsideron se në këtë çështje ekziston vetëm një provë dhe një provë aksesore- sms, lidhur me të pandehurin dhe me këtë provë – dëshmi të dëshmitarit M.R. i cili më parë ishte në cilësinë e bashkë të akuzuarit nuk mund të jetë provë që në bazë të tij gjykata ta mbështes aktgjykimin meritor. E po ashtu ka kontestuar dëshminë e tij si dëshmi jo reale dhe tërësisht kontradiktore duke e vlerësuar me mbrojtjen e tij deri sa ishte në cilësinë e të pandehurit.

Por Gjykata vlerëson se një pretendim i tillë i mbrojtjes është i paqëndrueshëm dhe atë nga arsyetimi që do të paraqitet më poshtë:

- fillimisht nuk është e ndaluar që i pandehuri ndaj të cilit përfundon procedura penale të mos mund të dëgjohet në cilësinë e dëshmitarit, edhe pse mbrojtësi i të pandehurit nuk i referohet normës konkrete që e ndalon dëgjimin e dëshmitarit megjithatë ligjvënësi përmes dispozitës së nenit 126 par.1 nënpar.1.3. të KPP-së ka përcaktuar se si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje ”... *i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët*”, kurse në rastin konkret ndaj të akuzuarit M.R. ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor me aktgjykim të formës së prerë dhe se tani nuk ka pengesë që ta merr statusin e dëshmitarit;

- gjithsesi në kontest të këtij pretendimi të mbrojtjes është e logjikshme dhe e justifikueshme që Gjykata me rastin e vlerësimit të dëshmisë së këtij dëshmitari të jetë maksimalisht e kujdesshme;

- dhe vlerësimin ta bëj mes tjerash edhe në kontest të ndryshimit të statusit të tij nga i pandehur në dëshmitar.

Andaj me këtë rast Gjykata të gjitha këto rrethana i pati parasysh, por megjithatë çmoj se kjo dëshmi ishte e besueshme dhe e saktë nuk u gjet as edhe një rrethanë që do ta dëmtonte besueshmërinë e saj posaçërisht detajet e përmendura sidomos raportet e tyre të krijuara me rastin e ndihmës që dëshmitari M.R. i dha të akuzuarit për nxjerrjen e letërnjoftimit dhe shkuarjen së bashku për në Serbi, pastaj marrja e parave në zarf nga dëshmitari M.R. pa i numëruar fare ato dhe pa i dhënë shumën të akuzuarit siç ishin marrë vesh (prej 150 €) tregon një besim të madh të ndërsjellë ndaj njëri tjetrit.

Kurse sa i përket pretendimit tjetër se aktgjykimi nuk mund të mbështetet në një provë të vetme përkatësisht dëshminë e dëshmitarit në rastin konkret M.R., po ashtu Gjykata vlerëson se në rastin konkret fillimisht nuk kemi pasur të bëjmë me një dëshmitar të vetëm pasi që dëshmia e tij është ndërlidhur edhe me provat tjera materiale përkatësisht edhe me SMS e dërguar nga ana e dëshmitarit tek i pandehuri e gjithashtu edhe elementet objektive përkatësisht provat tjera (ekspertiza dhe shikimi në paratë e falsifikuara) duhet të ndërlidhen në kontest të rrethanave të ngjarjes.

Po ashtu dispozita e nenit 262 par.1 të KPP-së “ *Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një*

*dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.”, është e qartë se Gjykata duhet dhënë mundësi të pandehurit përkatësisht mbrojtësit të tij që ta marrin në pyetje të pandehurin me qëllim të mundë ti paraqesin pikëpamjet e tyre për këtë dëshmiat e që në rastin konkret kjo e drejtë është ushtruar në mënyrë efektive nga ana e mbrojtjes dhe për më tepër në fazën e shqyrtimit gjyqësor.*

## **6. Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit dhe zbatimi i ligjit më të favorshëm**

Duke vlerësuar në aspektin juridik, Gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 244 paragrafi 1 të KPK-ës, meqë paraprakisht po e dinte se paratë e falsifikuara ia kishte dhënë tani dëshmitarit M.R. dhe me këtë i kishte vënë në qarkullim paratë e falsifikuara si të vërteta me dashje direkte.

Duke pasur parasysh faktin se nga 1 janari i vitit 2013 ka hyrë në fuqi Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gjykata sipas detyrës zyrtare ka aplikuar dispozitën e nenit 3 par.2 të KPRK-së zbatimi i ligjit më të favorshëm, “ *Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm*”, meqë për veprën penale nga neni 244 par.1 të KPK-së parashihet “*...dënim burgimi në kohëzgjatje prej një deri në dhjetë vjet*”, kurse neni 302 par.1 i KPRK-së ka përcaktuar “*dënim burgimi prej një deri në tetë vite*”, ashtu që të akuzuarin e ka shpallur fajtor sipas dispozitës së ligjit më të favorshëm përkatësisht nenit 302 par.1 të KPRK-së.

## **7. Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin M.R., Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të neni 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari deri më tani nuk rezulton se të jetë dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, se në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i moshës së re e që këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat lehtësuese se është i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar baba i tre fëmijëve kurse çmoi si rrethanë rënduese se ishte protagonist i ngjarjes dhe kishte rol dominant në tërë skenarin e ngjarjes.



Gjykata është e bindur se edhe me anë të këtij dënimi nën minimumin e përcaktuar ligjor në aplikim të dispozitës së nenit 76 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së, është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve të paraparë në nenin 41 të KPRK-ës, se edhe me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### **8. Llogaritja e paraburgimit dhe shpenzimet procedurale**

Në dënimin e shqiptuar Gjykata ka llogaritur kohën e qëndrimit në paraburgim ndaj të akuzuarit prej datës 02.11.2010 deri me datë 02.12.2010 dhe prej datës 31.08.2016 deri me datë 17.10.2016, duke aplikuar nenin 83 par. 1 të KPRK-ës.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPP-ës, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 /pesëdhjetë/€, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, e cila është caktuar duke pasur parasysh gjendjen ekonomike dhe komplikueshmërinë e kësaj çështje penale.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, PKR.nr.140/2015.**

**Sekretarja juridike,  
Albana Ajvazi**

**Kryetari i trupit gjykues,  
Agim MALIQI**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.